



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATI I POPULLIT

Nr. 757/1 prot.

Tiranë, më 31.8.2026

URDHËR

Nr. 174, datë 31.8.2026

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT “PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të rekomandimit nr. 12 të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026”.
2. Publikimin e Planit të Veprimit në faqen zyrtare të institucionit, www.avokatipopullit.gov.al.
3. Kabineti i Avokatit të Popullit dhe Sekretari i Përgjithshëm koordinojë dhe monitorojnë zbatimin e këtij plani dhe përgatisin raportimet periodike.
4. Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë mbi nivelin e zbatimit të planit realizohet përmes brenda afateve të raportimit, të përcaktuar në plan.
5. Ngarkohen Kabineti i Avokatit të Popullit, Sekretari i Përgjithshëm, Seksionet, MKPT dhe strukturat e tjera përgjegjëse, për zbatimin e masave sipas afateve përkatëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

ENDRIT SHABANI

Endrit Shabani



PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË REZOLUTËS SË KUVENDIT “PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026”

Nr.	Rekomandimi i Rezolutës	Masat konkrete për zbatim	Afati	Struktura përgjegjëse	Treguesit bazë dhe objektivi i synuar
1	Të rritet cilësia dhe të konkretizohen propozimet për ndryshime të nevojshme përmes rekomandimeve të strukturuar ligjore, si dhe të krijohet një mekanizëm i brendshëm për monitorimin e ndikimit të rekomandimeve pas miratimit të tyre.	• Rishikimi i metodologjisë së hartimit të rekomandimeve. • Përgatitja e një udhëzuesi praktik për shkrimin e rekomandimit dhe trajnimi i stafit. • Hartimi i procedurës standarde për hetimin kryesisht të çështjeve sistemike dhe për propozimet ligjore. • Krijimi i një regjistri elektronik dhe sistemi menaxhimi për monitorimin e rekomandimeve dhe zbatimit të tyre. • Ngritja e një njësie përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.	Nëntor 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Seksionet; Sektori IT dhe Pritja e Qytetarëve	Metodologjia e rishikuar, udhëzuesi i miratuar, njësia e monitorimit e ngritur dhe funksionale, regjistër funksional elektronik për rekomandimet dhe sistemi i menaxhimit të rekomandimeve funksional
2	Të hartohet dhe paraqitet në Kuvend një metodologji e standardizuar për matjen e ndikimit të ndërhyrjeve korrigjuese të institucionit, e cila të adresojë edhe zbatimin e rekomandimeve, me indikatorë të qartë të nivelit të zbatimit, verifikim në terren për rastet prioritare, publikim të të dhënave për të paktën 3 vjet dhe raportim periodik në komisionet përgjegjëse.	• Ngritja e grupit të punës. • Hartimi i metodologjisë për matjen e ndikimit të ndërhyrjeve korrigjuese të institucionit. • Hartimi i planeve të punës dhe treguesve të ndikimit për secilin seksion. • Miratimi dhe paraqitja në Kuvend. • Krijimi i databazës elektronike dhe publikimi i statistikave 3-vjeçare në faqen zyrtare.	Dhjetor 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Seksionet; Sektori IT dhe Pritja e Qytetarëve; Grupi i punës	Grup pune i ngritur, metodologjia e miratuar dhe e paraqitur në Kuvend; të dhënat statistike të publikuara.
3	Të angazhohet për finalizimin e Planit Strategjik 2026–2030 dhe planit të veprimit, duke përcaktuar objektiva të matshëm dhe indikatorë performance.	• Ngritja e grupit të punës. • Hartimi dhe finalizimi i Planit Strategjik 2026–2030. • Hartimi dhe finalizimi i Planit të Veprimit me KPI dhe mekanizma monitorimi. • Konsultimi i Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2026–2030 me partnerët dhe grupet e interesit.	Dhjetor 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Seksionet; Grupi i punës	Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit 2026 - 2030 të miratuar pas konsultimit.
4	Të zgjerohet dhe formalizohet puna në terren përmes inspektimeve periodike, ditëve të hapura, monitorimeve dhe takimeve komunitare, me fokus te grupet vulnerabël, përmes një programi të strukturuar vjetor me planifikim territorial dhe indikatorë ndikimi për secilin seksion.	• Hartimi i planit dhe kalendarit të inspektimeve periodike dhe monitorimeve. • Hartimi i planit dhe kalendarit për ditët e hapura dhe takimet komunitare. • Organizimi i ditëve të hapura dhe takimeve komunitare. • Zhvillimi i monitorimeve dhe inspektimeve periodike.	Dhjetor 2026	Kabineti; Seksionet; MKPT; Sekretari i Përgjithshëm; Zyrat Raionale;	Planet dhe kalendarët e inspektimeve dhe ditëve të hapura miratuara; Rritje e prezencës së Avokatit të Popullit në terren
5	Të përgatitet një raport i veçantë mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) të raportit periodik 2024.	• Analizë e plotë e rekomandimeve të CPT-së. • Verifikime në terren në institucionet e privimit të lirisë. • Takime me institucionet përgjegjëse. • Hartimi, publikimi dhe depozitimi i raportit në Kuvend.	Tetor 2026	MKPT dhe Kabineti	Raporti i veçantë mbi zbatimin e rekomandimeve të CPT-së i hartuar dhe i depozituar në Kuvend

Nr.	Rekomandimi i Rezolutës	Masat konkrete për zbatim	Afati	Struktura përgjegjëse	Treguesit bazë dhe objektivi i synuar
6	Të vijojë monitorimi dhe raportimi i fenomenit të dhunës dhe vrasjes së grave, duke evidentuar në vijimësi nevojat për ndërhyrje me qëllim përmirësimin e reagimit institucional.	- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave - Monitorimi i institucioneve përgjegjëse - Hartimi i raporteve tematike. - Rekomandime për përmirësimin e politikave publike.	Tetor 2026	Seksioni i Përgjithshëm dhe Kabineti	Raporte tematike mbi fenomenin e dhunës ndaj grave të hartuara dhe të depozituara në Kuvend
7	Të raportohet në mënyrë periodike dhe analitike në Kuvend mbi rekomandimet me nivel të ulët zbatimi, duke identifikuar fushat problematike dhe institucionet përgjegjëse me performancën më të dobët.	- Analizë periodike e rekomandimeve të pazbatuara. - Evidentimi i institucioneve me performancën më të dobët. - Raportimi periodik në Kuvendin e Shqipërisë, përmes seksionit analitik të raportit të unifikuar 4-mujor.	Dhjetor 2026	Kabineti dhe Sekretari i Përgjithshëm	Listë institucioneve me performancë të dobët, dhe fushave problematike, e hartuar dhe depozituar në Kuvend
8	Të merren masa për forcimin e angazhimit lidhur me çështjet e sistemit penitenciar, në përputhje me standardet e BE-së.	- Monitorime periodike dhe vizita pa paralajmërim në IEVP. - Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga MKPT. - Hartimi i një raporti të veçantë për kostot financiare dhe sociale të qëndrimit në IEVP.	Dhjetor 2026	MKPT; Seksioni i Veçantë	Monitorimet e realizuara në IEVP dhe raporti i veçantë i hartuar dhe i publikuar
9	Të vijojë angazhimi për realizimin me sukses të procesit të riakreditimit me status "A", sipas Parimeve të Parisit, duke identifikuar dhe paraqitur në Kuvend nevojat për përmbushjen e standardeve, me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme institucionale, si dhe të raportohet periodikisht mbi ecurinë e procesit.	- Ngritja e grupit të punës - Vetëvlerësimi sipas Parimeve të Parisit dhe identifikimi i nevojave për mbështetje institucionale nga Kuvendi. - Paraqitja zyrtare në Kuvend e nevojave për garancitë buxhetore dhe për miratimin e ligjit të ri organik. - Raportimi periodik mbi ecurinë e procesit, përmes ciklit të unifikuar 4-mujor.	Tetor 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Grupi i punës	Grupi i punës i ngritur; Vetëvlerësimi i kryer dhe lista e nevojave të institucionit të paraqitura në Kuvend.
10	Të sigurohet zbatimi në kohë i rekomandimeve dhe vendimeve, duke raportuar periodikisht çdo 4 muaj në Kuvend mbi masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre, në përmbushje të detyrimeve institucionale dhe standardeve evropiane.	- Përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit të rekomandimeve. - Ndjekje e zbatimit të rekomandimeve dhe raportim në Kuvend për çdo rekomandim të pazbatuar. - Raportim periodik (4-mujor) në Kuvend.	Dhjetor 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Seksionet	Raportet periodike të depozituara dhe rekomandimet e ndjekura zyrtarisht
11	Të bashkëpunohet me strukturat përgjegjëse të Kuvendit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës (KPI), brenda tremujorit të tretë të vitit 2026.	- Dërgimi i shkresës zyrtare Kuvendit për ngritjen e grupit të përbashkët të punës. - Pjesëmarrje aktive në hartimin dhe konsultimin e metodologjisë së standardizuar të KPI-ve. - Miratimi, zbatimi dhe trajnimi i stafit.	Shtator 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Grupi i përbashkët i punës	Grupi i përbashkët i punës i ngritur; metodologjia e standardizuar e KPI-ve e hartuar me konsultim.
12	Brenda 30 ditësh nga miratimi i rezolutës, të hartohet dhe publikohet plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, me masa konkrete, afate, struktura përgjegjëse, tregues bazë dhe objektiva, si dhe të raportohet periodikisht mbi nivelin e përmbushjes.	- Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit. - Publikimi në faqen zyrtare eeë.avokatipopullit.gov.al. - Monitorim i brendshëm i zbatimit dhe raportim periodik mbi zbatimin e tij.	Gusht 2026	Kabineti; Sekretari i Përgjithshëm; Seksionet	Plani i veprimit i miratuar, dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit